



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 119, dt. 03.07.2015

Në mbështetje të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 03.07.2015, pasi shqyrtoi detyrën e projektimit për hartimin e projektit “Rikonstruksion i ndërtesës ekzistuese të MZHU”, me investitor Ministrinë e Zhvillimit Urban, Tiranë, çështje e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e detyrës së projektimit për hartimin e projektit “Rikonstruksion i ndërtesës ekzistuese të MZHU”, Tiranë me këto kushte:
 - Të realizohet shtesa e propozuar e volumit në katin e tretë për të plotësuar linjën arkitektonike të objektit (sip = 94.86 m²)
 - Të ruhet korniza soletës në katin e dytë dhe kati i tretë të dallojë nga objekti autentik.
 - Sugjerohet që projekti të konsultohet me Institutin e Monumenteve të Kulturës gjatë procesit të projektimit
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

